



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2018

### V E N D I M

**Nr. 96, Datë 05/04/2018**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 161, datë 11.12.2017, e Znj. M. Ç., ku pretendohet për diskriminim, për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

### K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se Znj. M. Ç. ka ushtruar detyrën e Kryeinspektorit pranë Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, dega Gjirokastrë, nga data 26.04.2016, deri në datën 30.11.2017. Ankuesja është emëruar përkohësisht në këtë detyrë, nëpërmjet Urdhërit nr. 57, datë 25.04.2016, të Kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor. Në vijim, nëpërmjet Urdhërit nr. 99, datë 24.11.2017, të Kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, marrëdhëniet e punës me Znj. M. Ç., janë ndërprerë duke e shpallur absolutisht të pavlefshëm urdhërin e emërimit në detyrë, për shkak të mospërbushjes së kriteve të pozicionit të punës nga ana e saj.

Ankuesja ka përfunduar studimet dhe ka fituar titullin “mësuese e gjuhës dhe letërsisë greke”, pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore, të Universitetit “Eqerem Çabej”, Gjirokastër, në vitin 1999. Në vijim, në vitin 2009, është diplomuar dhe ka fituar titullin “ekonomiste për administrim publik”, pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, të Universitetit “Eqerem Çabej”, Gjirokastër. Ankuesja pretendon se është liruar nga detyra, pasi Kryeinspektori i Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, e ka diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore.

“Gjendja arsimore” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 1208/1 Prot., datë 28.12.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, njoftoi Inspektoriatin Shtetëror Shëndetësor, mbi ankesën e mësipërme, si dhe kërkoi informacion mbi çështjen e parashtruar nga ankuesja.
- Në përgjigje të shkresës nr. 1208/1 Prot., datë 28.12.2017, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Inspektoriatin Shtetëror Shëndetësor dërgoi shkresën nr.25, datë 08.01.2018, nëpërmjet së cilës e bën me dije Komisionerin se ankuesja M. Ç. është emëruar përkohësisht me Urdhërin nr. 57, datë 25.04.2016, të Kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, në pozicionin e Kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, dega Gjirokastër.

Emërimi është kryer në bazë të Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 301, datë 15.07.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të punësimit të inspektorëve shëndetësor pranë Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor”, ku përcaktohen kriteret e posaçme për arsimin, përvojën në punë, njohuritë dhe aftësitë. Këto kriterë ndahen në kriterë të përgjithshme dhe kriterë të posaçme, për arsimin, përvojën në punë, njohuritë dhe aftësitë. Tek këto të fundit parashikohet që aplikanti duhet të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë bachelor në degët e mëposhtëme: Mjekësi e përgjithshme, Higjenë, Stomatologji, Shëndet Publik, Biokimi (jo në fushën e mësuesisë), mjekësi veterinarë.

Pozicioni pranë ISHSH, dega Gjirokastrë është shpallur vakant pranë Departamentit të Administratës Publike dhe pritet fillimi i procedurave të konkursit për këtë pozicion pune. Në pozicionin vakant të Kryeinspektore, të ISHSH, dega Gjirokastrë është komanduar përkohësisht Përgjegjësjë e Sektorit të Inspektimit Sanitar, Znj. I. Ç.

2. Në vijim të ndjekjes së shqyrtimit të ankesës nr. 161, datë 11.12.2017, e Znj. M. Ç., mbështetur në Urdhërin nr. 26, datë 07.07.2018, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi u krye inspektim pranë Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor.

- Strukturat përgjegjëse të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor e informuan Komisionerin se para kryerjes së emërimit të Znj. M. Ç. në pozicionin e Kryeinspektore të ISHSH, dega Gjirokastrë, nuk ishte parë me kujdes çështja e plotësimit të kriterëve përkatëse nga ana e saj për atë pozicion pune, kriterë këto të parashikuara në Urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 301, datë 15.07.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të punësimit të inspektorëve shëndetësor pranë Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor”.

Ankuesja është ekonomiste, ndërkohë që përcaktimet e Urdhërit të sipërpërmendur, janë që aplikanti duhet të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë bachelor në degët e mëposhtëme: Mjekësi e përgjithshme, Higjenë, Stomatologji, Shëndet Publik, Biokimi (jo në fushën e mësuesisë), mjekësi veterinare. Emërimi i ankuses ishte i përkohshëm, deri në momentin e shpalljes së pozicionit vakant nga ana e Departamentit të Administratës Publike. Pasi është konstatuar që procesi i emërimit të ankuses ka qenë i parregullt, është vendosur shpallja e pavlefshmërisë së Urdhërit nr. 57, datë 25.04.2016, të Kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor. Pozicioni i Kryeinspektorit të ISHSH, dega Gjirokastrë është shpallur vakant në datën 07.01.2018. Në detyrën e kryeinspektore së kësaj dege, është komanduar Znj. I. Ç., e cila është pjesë e strukturave të brendshme të ISHSH Gjirokastrë. Nga verifikimet e kryera rezultoi se ndaj Znj. M. Ç. nuk është marrë asnjë masë disiplinore gjatë kohës që ka punuar në pozicionin e Kryeinspektore pranë ISHSH, dega Gjirokastrë, por gjithashtu duhet theksuar fakti se ISHSH nuk ka kryer asnjë vlerësim për punën e saj, duke qenë se ankuesja nuk ka qenë e emëruar sipas procedurave ligjore, që ndiqen për emërimin në detyrë të nëpunësit civil. Aktualisht, Znj. M. Ç. dhe ISHSH ndodhen në proces gjyqësor pranë gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë, pasi ankuesja ka depozituar padinë me objekt: Shfuqizimi i aktit administrativ, Urdhër nr. 90, datë 24.11.2017 “Për lirimin e kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Dega Gjirokastrë”, etj.

3. Në vijim të procedurave hetimore, Komisioneri iu drejtuar Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor me shkresën nr. 290, datë 23.02.2018, ku për efekt të shqyrtimit të ankesës kërkoi të disponojë informacion të mëtejshëm, lidhur me çështjet e mëposhtëme:

Ñ Lista e Kryeinspektorëve, në të gjitha degët e ISHSH, si dhe arsimimi i tyre. Bashkëlidhur të përcillen diplomat e tyre bachelor/master;

Ñ Përshkrimet e punës për Kryeinspektorët në të gjithë degët e ISHSH, në rrethe. Nëse përshkrimi i punës është i unifikuar dhe i njëjtë për të gjithë, të dërgohet një kopje e tij;

Ñ Urdhëri i Ministrisë të Shëndetësisë nr. 301, datë 15.07.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të punësimit të inspektorëve shëndetësorë pranë Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor” përmban miratimin e kriterëve të punësimit të inspektorëve shëndetësorë në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor në nivel qendror dhe në degën rajonale Tiranë, sipas Ankesit A bashkëlidhur tij. Referuar korrespondencës së mëparshme me Komisionerin, në ç’kontekst ka gjetur zbatim ky Urdhër për Kryeinspektorët e degëve të ISHSH në rrethe?

- Në përgjigje të shkresës nr. 290, datë 23.02.2018, të Komisionerit, ISHSH dërgoi shkresën nr. 25/1/5, datë 07.03.2018, ku parashtroi listën emërore të 8 kryeinspektorëve të ISHSH në Tiranë, Korçë, Durrës, Fier, Dibër, Lezhë dhe Berat. Njëkohësisht, në shkresë sqarohet se përshkrimi i punës është i unifikuar për të gjithë kryeinspektorët në rrethe dhe përshkruhen detyrat e tyre, por jo kriteret arsimore apo kriteret mbi kualifikimet e tyre. Bashkëlidhur shkresës së sipërpërmendur nuk është dërguar kopje e përshkrimit të tyre, të punës.

Njëkohësisht në shkresën e ISHSH nuk është dhënë asnjë sqarim mbi çështjen se në ç’kontekst ka gjetur zbatim Urdhëri i Ministrisë të Shëndetësisë nr. 301, datë 15.07.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të punësimit të inspektorëve shëndetësorë pranë Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor”, për Kryeinspektorët e degëve të ISHSH në rrethe.

**Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:**

**I. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të pretenduar nga ankuesja:**

Ankuesja M. Ç. ka përfunduar studimet e larta, në vitin 1999, pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore, të Universitetit “Eqerem Çabej”, Gjirokastër dhe ka fituar titullin “*mësuese e gjuhës dhe letërsisë greke*”. Në vijim, në vitin 2009, ajo është diplomuar dhe ka fituar titullin

“ekonomiste për administrim publik”, pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, pranë të njëjtit universitetit.

Nëpërmjet Urdhërit nr. 57, datë 25.04.2016, të Kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Znj. M. Ç. është emëruar përkohësisht në pozicionin e Kryeinspektore pranë ISHSH, Dega Gjirokastrë. Në vijim, nëpërmjet Urdhërit nr. 99, datë 24.11.2017, të Kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, “Për lirim të Kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Dega Gjirokastrë”, është shpallur pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit të saj për mospërbushje të kriterëve të pozicionit të punës, pa specifikuar se cili kriter nuk përmbushet nga ankuesja.

Në vijim të procedurave administrative për shqyrtimin e ankesës, justifikimi i Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor për shpalljen e pavlefshmërisë së Urdhërit nr. 57, datë 25.04.2016, të Kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, është se ankuesja nuk plotëson kriterin arsimor të përcaktuar në Urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 301, datë 15.07.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të punësimit të inspektorëve shëndetësorë pranë Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor”.

Duke iu përmbajtur Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 301, datë 15.07.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të punësimit të inspektorëve shëndetësorë pranë Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor”, rezulton se në pjesën urdhëruese të tij parashikohet shprehimisht: *“Miratimin e kriterëve të punësimit të inspektorëve shëndetësorë në Inspektoriatin Shtetëror Shëndetësor në nivel qendror dhe në degën rajonale Tiranë, sipas Ankesit A bashkëlidhur urdhërit.”*

Referuar Ankesit A, të Urdhërit të sipërpërmendur, rezulton se parashikohet shprehimisht: *“Kriteret e mëposhtme duhet të plotësohen nga çdo kandidat për: a) inspektor shëndetësor pranë sektorit të koordinimit dhe monitorimit të inspektimit në Inspektoriatin Shëndetësor në nivel qendror; dhe b) inspektor shëndetësor pranë sektorit të inspektimit sanitar, sektorit të inspektimeve të tjera shëndetësore, sektorit (njësisë kufitare) të inspektimit shëndetësor Rinas në Inspektoriatin Shtetëror Shëndetësor, dega Rajonale Tiranë”.*

Në vijim, Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 301, datë 15.07.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të punësimit të inspektorëve shëndetësorë pranë Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor” parashikon kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për secilin nga këto pozicione pune:

- 1. Përgjegjës sektori, kategoria III-a/1**, ku kriteri arsimor është përcaktuar, si vijon: *“Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë bachelor+master*

*shkencor në degët e mëposhtëme: Mjekësi e përgjithshme, Higjenë, Stomatologji, Shëndet Publik, Biokimi (jo në fushën e mësuesisë), Mjekësisë Veterinare.”*

- 2. Përgjegjës sektori, kategoria IV-a,** ku kriteri arsimor është përcaktuar, si vijon: *“Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë bachelor në degët e mëposhtëme: Mjekësi e përgjithshme, Higjenë, Stomatologji, Shëndet Publik, Biokimi (jo në fushën e mësuesisë), Mjekësisë Veterinare.”*
- 3. Inspektor, kategoria III-b,** ku kriteri arsimor është përcaktuar, si vijon: *“Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë bachelor+master profesional në degët e mëposhtëme: Mjekësi e përgjithshme, Higjenë, Stomatologji, Shëndet Publik, Biokimi (jo në fushën e mësuesisë), Mjekësisë Veterinare.”*
- 4. Inspektor, kategoria IV-b,** ku kriteri arsimor është përcaktuar, si vijon: *“Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë bachelor në degët e mëposhtëme: Mjekësi e përgjithshme, Higjenë, Stomatologji, Shëndet Publik, Biokimi (jo në fushën e mësuesisë), Mjekësisë Veterinare.”*

Sikurse rezultojnë nga sa më sipër, ky urdhër nuk parashikon kriteret e përgjithshme apo kriteret të posaçme për Kryeinspektorët në degët e ISHSH në rrethe, por vetëm për inspektorët shëndetësorë të cituar në Aneksin A të tij. Gjithashtu, duke iu referuar dokumentacionit të dërguar bashkëlidhur shkresës nr. 25/1/5, datë 07.03.2018, të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, rezultojnë se edhe Kryeinspektorët tjerë, të degëve të ISHSH, kanë arsimin të ndryshëm nga ai i përcaktuar në Urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 301, datë 15.07.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të punësimit të inspektorëve shëndetësorë pranë Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor”, duke vërtetuar faktin se ky urdhër nuk mund të përdoret për analogji edhe për këto pozicione pune, por vetëm për pozicionet e parashikuara shprehimisht në të. Për sa më sipër, rezultojnë si vijon: Kryeinspektori i Degës Korçë, ka përfunduar studimet bachelor për Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, pranë Universitetit “Kristal” dhe Master të Shkencave në të Drejtë Civile; Kryeinspektori i Degës Durrës ka përfunduar studimet Bachelor dhe Master për Shkenca Politike, pranë Fakultetit të Shkencave Politike të Univeristetit të Strugës, Maqedoni; Kryeinspektori i Degës Dibër ka përfunduar studimet bachelor për Drejtësi, pranë Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës.

Pavarësisht kësaj, Komisioneri konstaton se Znj. M. Ç. nuk ndodhet në të njëjtat kushte me kryeinspektorët në degët e ISHSH në rrethe, pasi emërimi i saj ishte i përkohshëm<sup>1</sup>, ndërkohë që

<sup>1</sup> Referuar Urdhërit nr. 57, datë 25.04.2016, të Kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor;

pozicioni i kryeinspektorit plotësohet në bazë procedurave përkatëse, të parashikuara në legjislacionin mbi nëpunësin civil.

Për sa më sipër, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”<sup>2</sup>, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe disfavorizues, për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor.

## **I. Shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga ankuesja.**

Ankuesja pretendon se diskriminohet për shkak të gjendjes arsimore nga ana e ISHSH.

“Gjendja arsimore” është shkak, për të cilin Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Nga analizimi në tërësi i fakteve dhe provave të administruara përgjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri ka konstatuar se lirimi nga detyra i ankuses, nga titullari i Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, është kryer nëpërmjet shpalljes së pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit të saj, për mospërbushje të kriterëve të pozicionit të punës. Përgjatë hetimit administrativ të ankesës, ISHSH ka sqaruar se shpallja e pavlefshmërisë së Urdhërit të emërimit të Znj. M. Ç. është kryer, pasi ajo nuk ka arsimin e duhur. Referuar sa më sipër, rezulton se nuk ekziston asnjë kriter arsimor i parashikuar shprehimisht për kryeinspektorët e ISHSH në rrethe. Dispozitat e Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 301, datë 15.07.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të punësimit të inspektorëve shëndetësorë pranë Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor” janë të vlefshme vetëm për përcaktimin e kriterëve të punësimit të inspektorëve shëndetësorë në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor në nivel qendror dhe në degën rajonale Tiranë, por jo për Kryeinspektorët në rrethe.

---

<sup>2</sup> Neni 7, pika 1, i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi parashikon: “ Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.



Në këtë kontekst, vlen të theksohet fakti që Kryeinspektorë të emëruar në degë të tjera të ISHSH, kanë arsim të ndryshëm, nga ai që pretendohet nga ISHSH dhe që parashikohet në Urdhërin e sipërpërmendur. Kjo është një provë që dëshmon që edhe në përshkrimet e punës për këto pozicione, kriteri arsimor nuk është i parashikuar shprehimisht. Këtu duhet theksuar fakti që pavarësisht se Komisioneri kërkoi të dispononte në cilësinë e provës një kopje të përshkrimit të punës së miratuar për pozicionin e kryeinspektorit të ISHSH në rrethe, ky dokument nuk u dërgua nga ISHSH. Pavarësisht sa më sipër, Komisioneri sjell në vëmendje faktin, se duke qenë se Kryeinspektorët e tjerë, në degët e ISHSH në rrethe, kanë arsimime të ndryshme, sikurse edhe ankuesja, atëherë gjendja arsimore nuk është shkak, për të cilin Znj. M. Ç. është trajtuar ndryshe, nga ta.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se Znj. M. Ç. nuk është diskriminuar nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, për shkak të gjendjes së saj arsimore.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, nenet 12 e 13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të gjendjes arsimore, të Znj. M. Ç., nga ana e Kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 45 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Irma BARAKU**

**KOMISIONERI**

(Shkak: gjendja arsimore  
Fusha: punësim)